



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
MBLEDHJA E POSAÇME E GJYQTARËVE

Nr. 224 prot.

Tiranë, më 17.01.2023

VENDIM

Nr. 2, datë 16.1.2023

PËR ZGJEDHJEN E ZNJ. HOLTA ZAÇAJ ANËTARE E GJYKATËS KUSHTETUESE

Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, e përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Sadushi	zëvendëskryetar;
Artur Kalaja	anëtar;
Ilir Panda	anëtar;
Ervin Pupe	anëtar;
Sokol Binaj	anëtar;
Albana Boksi	anëtare;
Sandër Simoni	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Medi Bici	anëtar;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Gentian Medja	anëtar;
Darjel Sina	anëtar;
Sokol Ngresi	anëtar;
Margarita Buhali	anëtare;
Enton Dhimitri	anëtar,

në mbledhjen e datës 16.1.2023, e cila kishte në rend të ditës zhvillimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, që është në emërtesë të Gjykatës së Lartë,

VËREN:

1. Sipas nenit 125 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata e Lartë është një nga organet që zgjedh 3 (tre) anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

2. Mbi bazën e njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për krijimin e një vendi vakant, për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtares Vitore Tusha, që sipas formulës së përcaktuar në Kushtetutë është në emërtesën e Gjykatës së Lartë, më datë 16.01.2017, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë shpalli thirrjen e shprehjes së interesit për të kandiduar në këtë pozicion. Për shkak të mosplotësimit të numrit të nevojshëm të kandidaturave, referuar edhe njoftimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, është vendosur rishpallja e thirrjes nga Gjykata e Lartë në datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe datë 31.01.2022.

3. Pas rishpalljes së thirrjeve në datat e mësipërme, lista e kandidatëve që aplikuan për këtë vend vakant, së bashku me dokumentacionin shoqërues, i është përcjellë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, organ që ka në kompetencë kryerjen e verifikimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve.

4. Për arsye të skualifikimit apo dorëheqjes të një pjese të kandidatëve dhe numrit të kufizuar të tyre, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vlerësuar t'i drejtohet disa herë Gjykatës së Lartë. Pas rishpalljes së thirrjes për katër herë radhazi, me shkresën nr. 612, datë 19.10.2022, Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i është drejtuar përsëri Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për këtë vend vakant, për shkak se kishin mbetur në garë vetëm dy kandidatë.

5. Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë më datë 28.10.2022, ka rishpallur thirrjen për plotësimin e vendit vakant të gjyqtares Vitore Tusha. Në përfundim të afatit 30 ditor për pranimin e kërkesave, pranë Gjykatës së Lartë, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, me shkresën nr. 6574, datë 5.12.2022, njoftoi Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se nuk u paraqit asnjë kërkesë e re për plotësimin e kësaj vakance, ndërsa dy kandidaturat ekzsituose, konkretisht zj. Elsa Miha dhe zj. Holta Zaçaj, rikonfirmuan qëndrimin për të vijuar kandidimin për këtë vend vakant.

6. Në kushte të tilla, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vendosi të vijojë me procedurat e vlerësimit dhe renditjes së këtyre dy kandidatëve dhe me shkresën nr. 677, datë 30.12.2022, i përcolli Gjykatës së Lartë listën e renditjes së kandidatëve së bashku me raportin dhe dokumentacionin përkatës. Në listën e përcjellë, kandidatja Holta Zaçaj është renditur e para me 84.72 pikë, kurse kandidatja Elsa Miha është renditur e dyta me 82.22 pikë.

7. Me vendimin nr. 1, datë 5.1.2023, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë vendosi thirrjen e Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë më datë 16.01.2023, për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

8. Mbi bazën e vendimit nr. 1, datë 24.2.2022, “*Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese*”, si dhe referuar listës së kandidatëve dhe renditjes së tyre, të përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, me Urdhrin nr. 8, datë 5.1.2023, miratoi fletën tip të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Fleta e votimit përmbante listën me kandidatët Holta Zaçaj dhe Elsa Miha, sipas renditjes së përcaktuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

9. Në datën 16.1.2023, u zhvillua Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ku morën pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (15 gjyqtarë), duke plotësuar kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes dhe realizimin e procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

10. Në datë 11.1.2023, kandidatja Elsa Miha ka paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe për dijeni edhe Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë një kërkesë me objekt rishikimin e vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 65, datë 22.12.2022 për vlerësimin e pikëzimit, duke parashtruar si argument kryesor parregullsi të zhvillimit të procesit ligjor nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në drejtim të mosdhënies së kohës së mjaftueshme për paraqitjen e dokumenteve e të mosmarrjes në shqyrtim të akteve të dorëzuara prej saj, duke iu referuar për këtë qëllim nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative që lidhet me rastin e rishikimit të vendimit të një organi publik, kur zbulohen rrethana ose prova të reja me shpresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen gjatë zhvillimit të procedurës administrative. Gjithashtu, më datë 12.01.2023, kjo kandidatë ka paraqitur kërkesë për pezullimin e procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, duke parashtruar si argument kryesor se, meqenëse ka paraqitur një kërkesë për rishikim të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, atëherë Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë duhet të pezullohet, derisa Këshilli të shprehet përfundimisht për kërkesën e saj.

11. Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë konstaton se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr. 65, datë 22.12.2022 ka përfunduar procedurën e vlerësimit dhe të pikëzimit të kandidatës Elsa Miha për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese dhe se me vendimin nr. 67, datë 22.12.2022 ka miratuar edhe listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant. Vendimi është bërë publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe u është njoftuar kandidatëve. Rezulton që kandidatja nuk ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit.

12. Ndërkohë me vendimin nr. 68, datë 29.12.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar edhe Raportin përfundimtar “*për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese [...]*.” Edhe ndaj këtij vendimi rezulton të mos jetë paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit (GJAA) brenda afateve ligjore.

13. Duke qenë se kjo kandidatë nuk ka ushtruar brenda afateve ligjore të drejtën e saj për të kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimmarrjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

kërkesa e saj nuk u pranua nga Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se procesi i zgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetues nuk mund të pezullohet nga kërkesat që paraqiten nga kandidatët në garë, përveçse nga një vendim gjyqësor. Procedura kushtetuese që ndjek Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, parashikohet vetëm në nenin 125(1) të Kushtetutës dhe nenin 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar). Sipas këtyre dispozitave funksioni i Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është vetëm ai i votimit ose jo për listën e kandidatëve të përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe jo edhe i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që mund të kenë kandidatët e tashëm apo të shkuar, me vendimmarrjet e KED. Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nuk vepron si gjykatë, por si një forum me kompetencën e vetme të votimit të një prej kandidatëve të listës së përcjellë nga KED.

14. Duke e vlerësuar këtë kërkesë si të pabazuar, Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë që ka kompetencën kushtetuese dhe ligjore vetëm për të zgjedhur anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me listën e përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vijoi me procesin e votimit.

15. Referuar Rregullores së Mbledhjes së Posaçme, procesi i votimit u administrua nga komisioni i posaçëm i votimit, në përbërje të të cilit janë kancelari i Gjykatës së Lartë, kryesekretarja dhe një sekretare gjyqësore.

16. Në përfundim të procesit të votimit, komisioni i votimit, pas numërimit të fletëve të votimit, deklaroi numrin e votave të marra nga kandidatët, nga ku rezultoi se kandidatja Holta Zaçaj mori 6 (gjashtë) vota, kandidatja Elsa Miha mori 6 (gjashtë) vota, ndërsa 3 (tre) vota u shpallën të pavlefshme, për arsye se nuk ishin për asnjërin nga kandidatët.

17. Referuar nenit 7/ç, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese që parashikon se kandidati fitues duhet të sigurojë një shumicë prej 3/5 të votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe, në kushtet kur asnjëri prej kandidatëve nuk arriti të sigurojë shumicën e votave të nevojshme, kandidati që është i pari në listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të hartuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, konsiderohet *ipso lege* i zgjedhur në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 125 të Kushtetutës dhe të nenit 7/ç, pika 4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë,

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e Znj. Holta Zaçaj anëtare të Gjykatës Kushtetuese me mandat të pjesëshëm, deri në kryerjen e ripërtëritjes në vitin 2025.
2. Ky vendim i dërgohet Kryetarit të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi botohet në Fletoren Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Artur Kalaja
Anëtar



Ilir Panda
Anëtar



Sokol Sadushi
Zëvendëskryetar



Albana Boksi
Anëtare



Sokol Binaj
Anëtar



Ervin Pupe
Anëtar



Medi Bici
Anëtar



Asim Vokshi
Anëtar



Sandër Simoni
Anëtar



Darjel Sina
Anëtar



Gentian Medja
Anëtar



Arbena Ahmeti
Anëtare



Enton Dhimitri
Anëtar



Margarita Buhali
Anëtare



Sokol Ngresi
Anëtar

